



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:270380

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05944754

K.Dh.Sh.II.nr.802/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Erdi Rproducts” Shpk me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Labinot Vata, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, KA.nr.364/23 të datës 12.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, KA.nr.364/23 të datës 12.03.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, KA.nr.364/23 të datës 12.03.2024, në dispozitivin I. të aktgjykimit

është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Erdi Rproducts” Shpk, është Anuluar vendimi nr.prot4088 2/23 i datës 26.07.2023 i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Njoftimi për Pezullim me nr.prot 4088 i datës 19.07.2023 i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit. Nën pikën II. është vendosur, Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën III. lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit paditësi udhëzohet në procedurë kontestimore. Nën pikën IV. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr.prot 4088 2/23 i datës 26.07.2023 dhe Njoftimi për pezullim me nr.prot 4088 i datës 19.07.2023 të nxjerra nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave dhe Inspektorati i Mbrojtjes dhe Mjedisit, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.364/23 të datës 11.12.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Nën pikën V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar e paditura, me të cilën në tërësi e kundërshton aktgjykimin e ankimuar për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës jo kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ankesën e ushtruar kundër aktgjykimit KA.nr.364/23 të datës 20.02.2024 si të bazuar, të refuzon kërkesëpadinë e paditësit si t pa bazuar me ligj dhe të lë në fuqi vendimet kontestuese si të ligjshme.

Në përgjigjen në ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, duke theksuar se ankesa e parashtruar nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 178 (b) të LPK-së sepse në asnjë rast ankesa nuk përmban deklaratën nëse aktgjykimin kundërshtohet në tërësi ose në pjesët e caktuara të tij. Po ashtu, ankesa nuk i përmbahet nenit 178 (c) pasi që në asnjë mënyrë në arsyetim nuk paraqiten shkaqet e ankimimit, për shkak se arsyetimi është kontrovers dhe kundërthënës me vetveten pasi që ankesa nuk merret me aktgjykimin e gjykatës dhe konstatimet e tij por me pëlqimin mjedisor i cili as që nuk ka qenë fare në trajtim nga ana e gjykatës në rastin e vendosjes me aktgjykim. Andaj ka kërkuar nga Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë që të refuzoj ankesën si të pa themeltë dhe të vërtetoj aktgjykimin e goditur me ankesë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të

ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë (MMPH), ka nxjerrë vendimin me nr prot.4088/23 të datës 19.07.2023 me të cilin vendim është urdhëruar operatori “Erdi Rproducts” Shpk-Prishtinë, përkatësisht B.Z., proanr, me aktivitet dhe veprimtari të planifikuar për fabrikën për trajtimin teknik të mbeturinave në lokacionin Varosh, Komuna e Ferizajt që 1. Të pezulloj përkohësisht fillimin e realizimit të projektit për ”Fabrikën për trajtimin teknik të mbeturinave” për prodhimin e energjisë elektrike, në lokacionin Varosh Komuna e Ferizajt, projektit të planifikuar sipas raportit të VNM-së dhe vendimit të pëlqimit mjedisor të lëshuar nga MMPHI, vendimin nr.2/5905/ MMPHI të datës 21.12.2022 (nr.prot. 5905-2/22; të datës 29.12.2022). 2. Njoftohet organi kompetent pranë MMPHI-së, që ka dhënë vendimin e pëlqimit mjedisor me nr.22/5905/MMPHI, datë 21.12.2022 (nr.prot 5905-2/22; datë 29.12.2022 për subjektin “Erdi Products”-Shpk-Prishtinë, që në afat të paraparë ligjor, të rishikoj procedurën mbi dhënien e pëlqimit mjedisor duke marrë parasysh të gjeturat për rastin në fjalë.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datën 20.02.2024 në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të përfaqësueses së autorizuar të paditurës (neni 41 i LKA-së), pas administrimit të provave, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar K.A.nr.364/23 datës 12.03.2024, me të cilin ka aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Erdi Rproducts” Shpk, është Anuluar vendimi nr.prot4088 2/23 i datës 26.07.2023 i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Njoftimi për Pezullim me nr.prot 4088 i datës 19.07.2023 i nxjerrë nga Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit.

Dhoma e Shkallës së parë në arsyet e aktgjykimin të ankimuar ka theksuar se gjykata gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur, vlerëson se i padituri me rastin e nxjerrjes së një vendimi kontestues, nuk ka arritur që të ndërtoj strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, siç është përcaktuar me nenin 47 par.1 nën par. 2 të Ligjit nr. 05/L-

031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) që i padituri ka theksuar, pezullohet fillimi i realizimit të projektit deri në rishqyrtimin e procedurës mbi lëshimin e pëlqimit mjedisor, me arsyetimin e mungesës së dispozitave ligjore mbi trajtimin termik të mbeturinave, arsyetim ky i cili si i tillë është i pamjaftueshëm për palën, pasi që këto nuk janë rrethana të cilat janë paraqitur pas pajisjes për pëlqim mirëpo të njëjtat kanë qenë të njohura para se paditësi të paraqes kërkesë për pëlqim. Sipas vlerësimit të gjykatës i padituri është dashur të vlerësoj nëse ekzistojnë rrethanat të cilat konform dispozitave ligjore mund të japin bazë për shfuqizimin e tërësishëm të lejes mjedisore, mirëpo jo të pezulloj procedurën në afat të pa përcaktuar duke krijuar pasiguri juridike dhe shkelje të parimit të pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme të paditësit pasi që i njëjti deri në seancën e shqyrtimit kryesor dhe as gjykata nuk është njoftuar nga i padituri nëse janë marrë veprime të mëtejme, andaj gjykata vlerësoj se lënia në fuqi e pezullimit të fillimit të punimeve në afat të pa përcaktuar përderisa paditësi është i pajisur me leje mjedisore, është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e aktit të kontestuar në përputhje me nenin 4 par.1 të LPPA-së, pasi që i padituri nuk ka vepruar nga data 19.07.2023 e deri në ditën e shqyrtimit kryesor të kësaj çështje, gjykata vlerësoi se ka humbur tashmë efekti i pezullimit të përkohshëm të fillimit të punimeve, andaj vendosi që të anuloi vendimet kontestuese dhe se ky aktgjykim të zëvendësoj aktet e anuluar. Lidhur me kërkesën e paditësit për kompensimin e dëmit, gjykata vendosi që të njëjtën ta udhëzoj që kërkesën e tij pasurore ta realizoj në procedurë kontestimore dhe gjykata refuzoj propozimin e përfaqësuesit të paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare pasi që gjykata vlerësoi se ishte me interes publik që kjo çështje të zgjidhet pa ndonjë vonesë duke qenë se gjykata përmes aktvendimit KA.nr.364/23 e datës 11.12.2023 ka shtyrë ekzekutimin e vendimit nr.prot 4088 2/23 të datës 26.07.2023 dhe njoftimin për pezullim me nr.prot 44088 të datës 19.07.2023 të nxjerra nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe Inspektorati i Mbrojtjes dhe duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes që është objekt i këtij konflikti administrativ, gjykata vlerësoi se është më me interes që fillimisht të zgjidhet çështja e ligjshmërisë së akteve kontestuese. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e tjera të palëve dhe provat tjera të administruara, mirëpo të njëjtat nuk ishin në ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje të konfliktit administrativ.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerësimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, e pranon si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës, apo zbatim të gabuar të drejtës materiale, sikurse pretendohet në ankesë. Dhoma e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në

kuptim të nenit 41 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar si të bazuar Kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se aktvendimi i gjykatës i datës 11.12.2023 është i paqëndrueshëm i pa bazuar pasi që i njëjti nuk bazohet fare në faktet po ashtu shton se nuk ka heshtje administrative pasi që e paditura ka vendosur lidhur me ankesën e ushtruar, respektivisht vendimin e komisionit të Shqyrtimit të Ankesave datë 31.07.2023 dhe akti përcjellës me ref: KSHA 4088-3/23 datë 02.08.2023 të paditurës i është cenuar e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke qenë se Dhoma e Shkallës së Parë me vendimin e saj me të cilin ka aprovuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës 31.07.2023. Këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i Dhomës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës jokontestimore e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Të paditurës i është dhënë mundësia që t'i paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se vendimi i gjykatës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nuk i është referuar ndonjë prove materiale me të cilën do të dëshmohej pretendimi i paditësit për dëm të pariparueshëm që do të shkaktohej, duke saktësuar se në çfarë mase janë dhënë ajo lartësi kur as projekti nuk është aprovuar dhe as punimet nuk kanë filluar. E paditura deklaron se vendimi i ankimuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi, se vendimi nuk është marr me shkelje ligjore, është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Këto pretendime kolegji i refuzon si të pa bazuara ngase vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të

rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Ngase edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë pajtohet me arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar se e paditura ka pasur obligim ligjor që lidhur me kërkesën e paditësit për realizimin e projektit “Fabrika për trajtimin termik të mbeturinave” të lëshoj akt administrativ që i plotëson elementet e detyrshme të aktit administrativ nga nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, andaj edhe kolegji e vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka anuluar njoftimin për pezullim e datës 19.07.2023 të të paditurës sepse kjo mënyrë e vendimarrjes krijon pasiguri juridike në parimin e shqyrtimit të ligjshmërisë së kërkesesës në këtë rast paditësit. Kolegji e kësaj gjykate gjithashtu në shkresat të lëndës nuk gjen prova se i padituri ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret administrativ pas pezullimit të fillimit të punimeve në realizimin e projektit të lartë cekur, edhe pse paditësi është i paisur me leje mjedisore.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.802/24 datë 11.07.2024

Kryetare e kolegjit

Franciska Zhitija Ymeri